



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Republika e Kosovës
Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke /
Ministry of Education and Science

Departamenti i Arsimit të Lartë dhe Shkencës

Departamenti i Arsimit të Lartë si dhe Këshilli Shkencor i MASH në vazhden e aktiviteteve të tyre, bazuar në dispozitat e Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore nr.04/L-135, bazuar në planin e veprimit të Programit Kombëtar të Shkencës në lidhje me përkrahjen e studimeve të doktoraturës në 500 universitetet më të mira në botë, shpall:

KONKURS
(Për ndarjen e granteve (bursave) të doktoraturës)

Me të cilin ftohen studentët kosovarë që ndjekin studimet e doktoraturës në 500 universitetet më të mira në botë që të konkurrojnë për përfitimin e një granti të doktoraturës në vlerë vjetore prej 7500 eurosh. Konkursi është publik dhe vlen për studentët shtetas të Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh promovimin e barazisë gjinore, etnike, fetare dhe racore. Do të përkrahen studentët që nuk marrim bursë apo ndihmë financiare nga institucionet vendore apo ndërkombëtare, apo që në marrëveshje me institucionin ku punojnë (universitetin apo institutin) kanë marrëveshje për mungesë me pagesë për kohën e kryerjes së studimeve të doktoratës. Merren parasysh studentët që kanë përfituar ndonjë bursë apo lloj tjetër të financimit që mund të jetë i pjesshëm (që nuk i plotëson nevojat financiare për studime njëvjeçare sipas standardeve të vendeve ku është selia e universitetit). Studentët me bursa të plota nuk përkrahen. Për të konkurruar në konkurs, studentët e interesuar duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- CV (Biografia)
- Studenti të jetë shtetas i Republikës së Kosovës – dëshmi: letërnjoftimi ose pasaporta e Republikës së Kosovës.
- Vërtetimi nga institucioni kosovar ku studenti është i punësuar, nëse studenti është lëshuar me pagesë për kryerjen e studimeve ose jo.
- Vërtetimi nga universiteti ku studenti i vijon studimet apo është regjistruar (studentët që kanë fituar të drejtën për studime, por ende nuk i kanë regjistruar apo nuk i vijnë ato, nuk përkrahen) në studimet e doktoraturës.
- Vërtetimi nga universiteti mikpritës se kandidati nuk ka bursë nga ky universitet apo nuk merr pagesë tjetër si pjesë e ndonjë projekti hulumtues në atë universitet dhe vërtetimin se kandidati nuk pranon ndonjë mbështetje financiare të natyrës tjetër nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor (studentët me bursa jo të plota apo me mbështetje jo të plotë financiare mund të mbështeten, në raste të veçanta).
- Studentët që nuk janë fillestarë duhet të sjellin dëshmi lidhur me provimet e dhëna apo dokumente origjinale që dëshmojnë arritjen e kushteve specifike që kërkon universiteti i veçantë për kryerjen me suksese të pjesës së kaluar të studimeve (provimet, pjesëmarrja në projekte hulumtuese shkencore, pjesëmarrja në konferenca, botime etj. Kjo vërtetohet me një dokument origjinal të nënshkruar dhe të vulosur nga autoritetet e universitetit).
- Deklaratën e noterizuar se studenti pas kryerjes së studimeve do të kthehet në Kosovë si dhe deklaratën nën betim, se studenti nuk merr bursë apo ndonjë ndihmë financiare tjetër.
- Një vërtetim zyrtar se universiteti është i ranguar ndër 500 më të mirët në botë.

Përparësi kanë studentët që studiojnë në universitetet e ranguar më së larti në rangimet ndërkombëtare të universiteteve dhe fusha e studimeve të tyre bën pjesë në 5 plus 1, prioritetet kombëtare në bazë të Planit Kombëtar të Shkencës.

- Nuk mbështeten studentët që tashmë kanë përfunduar ciklin e ligjëratave apo që janë para mbrojtjes së disertacionit.
- Dokumentet relevante duhet të jenë të përkthyer nga një përkthyes zyrtar.
- Do të merret parasysh rangimi i universiteteve nga **Lista e Shanghait**.
- Konkursi mbetet i hapur (nga data 12.10.2020 deri më 23.10.2020 nga dita e shpalljes në gazeta, në uebfaqen e MASH dhe mediat elektronike.
- Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në arkivin e MASH.
- Informatat shtesë mund të merren tek zyrtari kontaktues në MASH znj. Yllza Memeti, në zyrën 302/ b. Email;Yllza.Memeti@rks-gov.net tel për kontakt : 038 211-867.
- Aplikimi duhet të dorëzohet në një zarf të mbyllur ku të jetë shkruar “Aplikimi për grantet e doktoraturës” dhe në CD në adresën : Rr. “Agim Ramadani” p. n, 10000-Prishtinë, Kosovë.
- **Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.**